



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Prishtinë, 27 Prill 2018

Komunikatë për medie

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP-i-i ka finalizuar Buletinin e I-rë me vendimet e PZAP-it për Zgjedhjet Komunale dhe për Kryetar të Komunave si dhe për Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës për proceset zgjedhore nga viti 2009 – 2016.

Edicioni i parë i Buletinit tregon disa arritje të PZAP-it për periudhën e theksuar me lartë dhe përmban disa nga rastet me të rëndësishme të vendimeve për të gjitha fazat e procesit zgjedhor lidhur me ankesat dhe apelet e parashtruara në mbrojtjen e të drejtës zgjedhore.

Buletini do të jetë një mundësi e mire dhe e dobishme për parashtruesit e ankesave dhe të apeleve, po ashtu edhe të botes akademike dhe shoqërisë civile, që të mësojnë se si janë vendosur rastet e natyrave të ndryshme të shkeljeve në zgjedhje në të kaluarën nga PZAP-i dhe këto vendime të mund të shërbejnë si mësim për tu shfrytëzuar në zgjedhjet e ardhshme në raste të ngjashme.

PZAP-i është themeluar në vitin 2009 në bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Fillimisht institucioni është quajtur Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia – KZAP dhe përbëhej prej 5 (pesë) anëtarëve përfshi kryesuesin, ndërsa nga vitin 2010 ka ndërruar emërtimin në Panel Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia – PZAP dhe përbëhet prej 10 anëtarëve përfshi kryesuesin. Sekretariati i PZAP-it në përbërjen e tij numëron 10 zyrtare të administratës përfshi kryesuesin e sekretariatit. Në përdhën që e mbulon Buletini, PZAP ka vendosur për 28,168 raste dhe ka shqiptuar dënime në gjoba në vlerë prej 922,920 €, fonde këto që i janë transferuar në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Ky projekt është përkrahur nga Fondacioni Ndërkombëtarë për Sisteme Zgjedhore – IFES.

Buletinin mund të e shkarkoni në linkun/Vegzen: <http://www.pzap-ks.org/?cat=123>